



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 62

Prishtinë, më 13 prill 2010, në orën 13: 00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT TË SHËNDETËSISË, TË PUNËS
DHE TË MIRËQENIES SOCIALE**

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj, Qamile Morina, Flora Brovina, Nurishahe Hulaj, Gjylnaze Sylaj, Teuta Hadri dhe Vezira Emrush.

I ftuar: Nenad Rashiq – ministër i Ministrisë së Punës dhe i Mirëqenies Sociale.

Të pranishëm: Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Shpresa Haxhijaj - administratore, Nora Sahatçiu - UNDP, Nexhat Shatri – Zyra e Presidentit.

Mbledhjen e kryesoi: Sadik Idriz, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës,**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 06. 04. 2010,**
- 3. Takimi me ministrin e Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale, Nenad Rashiq,**
- 4. Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 06. 04. 2010

Kryesuesi konstatoi se Komisioni i Shëndetësisë, Komisioni i Punës dhe i Mirëqenies Sociale e miratuan procesverbalin e mbledhjes së kaluar pa vërejtje.

3. Takimi me ministrin e Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale, Nenad Rashiq

Sadik Idriz – E kemi ftuar ministrin e MPMS-së, Nenad Rashiq, ta informojë Komisionin për ligjet e parapara në strategjinë legislative, për planet dhe për prioritetet e Ministrisë. Së pari kërkojmë të na informojë për Ligjin e punës, i cili sipas strategjisë është dashur të vinte në Kuvend në mars, por ende nuk ka ardhur. Kemi edhe pyetje të tjera për ministrin lidhur me ligjet dhe me punën e Ministrisë. Hap debatin.

Rita Hajzeraj – Nga ministri presim të na njoftojë për çështjet, të cilat i kemi ngritur edhe më parë, që kanë të bëjnë me ligjet dhe me punën e Ministrisë. Çështja më e rëndësishme që na shqetëson është Ligji i punës. Do të diskutojmë edhe për ligjet e tjera, si: Ligjin e pensioneve, Ligjin e skemës sociale dhe Ligjin e grevave, i cili nuk mund të kalojë në Kuvend para Ligjit të punës. Kërkojmë të na përgjigjet fillimisht për Ligjin e punës, pastaj për ligjet e tjera, sidomos edhe për Ligjin e veteranëve të luftës.

Teuta Hadri - Kërkoj të dëgjojmë nga ministri kur saktësisht do të vijë në Kuvend Ligji i punës, që para qytetarëve të jemi sa më transparentë.

Gjylnaze Sylja – Nga ministri kërkojmë të na njoftojë për procesin dhe për vështirësitë e Ligjit të punës dhe për afatin e saktë se kur do të vijë ai në Kuvend. Pas njoftimit për këtë Ligj të rëndësishëm do të kalojmë edhe në pika të tjera, lidhur me punën e Ministrisë, të cilat na interesojnë.

Flora Brovina – Jemi shumë të interesuar për procedimin e Ligjit të punës, sepse ai, sipas strategjisë, në mars është dashur të vinte në Kuvend. Më parë jemi njoftuar se Ligji ndodhet në Ministrinë e Financave, por nuk e dimë në ç’fazë është procedura. E kemi marrë edhe Ligjin e grevave, por qëndrim i Komisionit është se asnjë ligj, që ka të bëjë me Ligjin e punës, nuk do ta miratojmë para Ligjit të punës. Dëshirojmë ta dimë arsyen e vërtetë pse Ligji i punës nuk po vjen në Kuvend. Pyetja tjetër ka të bëjë: Ku keni mbetur me dialogun social?

Qamile Morina – Edhe unë jam e brengosur që ende nuk kemi ligj të punës. Pyetjet e mia, përveç Ligjit të punës, kanë të bëjnë edhe me disa çështje të tjera. E para ka të bëjë me takimin, që e keni pasur me Sindikatën e PTK-së. Keni thënë se do t’i mbroni të drejtat e punëtorëve sipas ligjit. Për cilin ligj e keni pasur fjalën dhe sa do të mund t’i mbroni këta punëtorë në procesin e privatizimit? E dyta ka të bëjë me projektet e BE-së dhe të ITAS-it. Këtë vit e keni filluar një projekt. Sa është vlera e tij? Këtë vit i keni ndarë 100 mijë euro për rindërtimin e shtëpive në Mitrovicë. A është realizuar ky projekt dhe në cilën pjesë është realizuar? Në organogramin e Ministrisë i keni edhe Divizionin e Ligjeve, edhe Divizionin e Mbikëqyrjes së Ligjeve, kërkoj nga ju që këto divizione të punojnë më shumë, që sa më par t’i kemi ligjet bazike: Ligjin e punës dhe Ligjin e pensioneve.

Nurishahe Hulaj – Kemi shumë sfida dhe qytetarët presin zgjidhje nga ne. Ministri në ftesë i ka pasur edhe pyetjet që na interesojnë. Do ta shtroj një pyetje më të veçantë lidhur me ndalesën, që u është bërë pensionistëve tanë, që kanë punuar në Zvicër. A ka ndërmarrë diçka Ministria që të gjejë zgjidhje?

Vezira Emrush – E falënderoj ministrin, që i është përgjigjur ftesës. Ta dëgjojmë përgjigjen e tij për pyetjet e shtruara, pastaj mund të bëjmë edhe pyetje shtesë.

Nenad Rashiq – Pyetjet tuaja janë për çështje jetike të qytetarëve të Kosovës. Ligji i punës është i rëndësishëm. Kemi punuar shumë që ta kemi këtë Ligj. Më ka ardhur shumë keq që në vitin 2008 është tërhequr nga procedura. Tani e kam parë se nuk është lehtë të miratohet. Kemi shumë trysni nga ndërkombëtaret për të. Aty janë disa çështje teknike. Për këtë nuk kemi mundur ta sjellim në Kuvend. Shumë shpejt do ta kemi edhe pëlqimin e grupit të punës dhe të partnerëve ndërkombëtarë dhe Ligjin

do ta sjellim në Kuvend. Buxheti ynë nuk mund ta përballojë koston e këtij Ligji, sepse në të parashihihen shumë beneficione për punëtorët tanë. Jemi në bisedime me BB-në dhe me FMN-në që t'i rregullojmë edhe këto çështje teknike, që kushtojnë afër 1.8 milion euro në vit. Detyra jonë është që Ligjin ta bëjmë sa më të qëndrueshëm financiarisht. Kam biseduar edhe me ministrin e Financave dhe kam insistuar që edhe ky Ligj të përfshihet në marrëveshjen e ligjeve, që do të miratohen këto ditë. Të jesh anëtar i FMN-së dhe i BB-së, nuk do të kesh vetëm beneficione. Në fillim do të kesh detyrime pastaj beneficione. Pyetje tjetër ishte edhe Ligji për asistencën sociale. Për të e kemi shqyrtuar edhe dokumentin e quajtur „*Letra e Bardhë*”. Komentet në të ishin pozitive, por ende jemi duke pritur që ai të financohet nga Konferenca e Donatorëve. Financimi i tij e ka ndalur edhe Ligjin e asistencës sociale. Pyetja pasuese ishte për Ligjin e sigurimit pensional, i cili ka kosto shumë të lartë - 57 milionë euro dhe nuk do të pranohet nga BB-ja dhe nga FMN-ja. Me buxhetin tonë, me shumë prioritet, është vështirë ta miratojmë këtë Ligj.

Planet dhe prioritetet e Ministrisë për vitin 2010 janë të shumta, por një nga projektet, prej të cilit presim shumë, është ai i punësimit, i financuar me 5 milionë euro nga Komisioni i BE-së. I gjithë Projekti i punësimit kap shumën 60 milionë euro dhe zgjat 3 vjet. MPMS-ja do të financojë me 2.5 milionë euro. Nëse do të menaxhohen mirë këto projekte, Komisioni Evropian do të financojë edhe projekte të tjera. Ministria ka edhe shumë projekte të tjera të punësimit, por punësimi do të jetë sfidë edhe për një kohë të gjatë.

Lidhur me dialogun social, para dy javësh kemi pasur një takim me partnerët e KES-it. Kemi biseduar edhe për punën dhe për rregullativën e KES-it.

KES-i tani i ka 4 partnerë: përfaqësuesit e Qeverisë, ata të shoqërisë civile, punëdhënësit dhe punëmarrësit.

OEK-u i ka 4 anëtarë, AKB-ja 1 anëtar, BSPK-ja 3 anëtarë, KSLK-ja 2 anëtarë dhe ministrat e MPMS-së, të MEF-it, të MTI-së, të MASHT-it dhe të MSH-së. Një nga anëtarët e KES-it do të jetë kryesues. Çdo 6 muaj do të jetë kryesues një nga partnerët e dialogut social. Dialogu social çdo herë do të jetë prioritet për MPMS-në.

Po përpiqemi që edhe pengesat teknike të Ligjit të punës të kalohen që t'i kemi edhe Ligjin e punës, edhe Ligjin e sindikatave dhe atë të grevave.

Në takimin me Sindikatën e PTK-së, kam premtuar se do të bëj përpjekje që gjatë negociatave me investitorët të sigurojmë marrëveshje që kontratat e punës të punëtorëve të PTK-së të jenë së paku për tre vjet. Projekti IPA-s , është për ngritjen e kapaciteteve .

Shuma e ndarë prej 100 mijë euro është për Projektin e rindërtimit e shtëpive në Mitrovicë. E kemi një memorandum me komunën e Mitrovicës, që është zbatuese e Projektit. Mjetet i janë transferuar komunës.

Për çështjen e pensionistëve tanë në Zvicër jemi në kontakt dhe po zhvillojmë negociata me autoritetet zvicerane. Ky është një problem tekniko-formal. Mendoj se shumë shpejt do të kemi edhe zgjidhje.

Sadik Idriz – E falënderoj ministrin, por njoftimet para Komisionit dhe propozimet e ofruara duhet të jenë konkrete. Brengosëse është fakti se zgjidhje pozitive për Ligjin e punës nuk ka. Nuk ka më arsye që Ligj të shtyhet. Edhe dialogu social është i lidhur me të.

Teuta Hadri – Duhet të jemi më konkretë dhe të kemi afat të saktë se kur do ta kemi Ligjin e punës. Janë tri mandate që thuhet se nuk ka buxhet për miratimin e tij. Ju si ministër a e keni shqyrtuar mundësinë t'i reduktoni disa gjëra në mënyrë, që ky Ligj të mos ketë kosto të lartë dhe të miratohet? Si deputet nuk kemi bërë asnjëherë amendament, që do ta rriste koston e tij. Nëse e keni ditur se Ligji nuk mund të kalojë për shkak të koston së lartë, nuk është dashur të përfshihet fare në strategjinë legislative. Ne kemi përgjegjësi para popullatës për miratimin e tij.

Vezira Emrush - Ministri tha se jemi në bisedime me BB-në dhe me FMN-në për miratimin e Ligjit të punës. E kam një pyetje për të: A është bërë ndonjë analizë sa ndajnë buxhet për Ligjin e punës dhe për Ligjin e fondit pensional vendet e rajonit. BB-ja dhe FMN-ja si mund t'ua lejojnë të gjitha vendeve të rajonit këto implikime buxhetore, ndërsa neve na thonë ndal?

Kur është fjala për Ligjin e punës, si mund të miratohen ligjet e tjera, kur nuk e kemi ligjin bazik të punës?

Dialogu social me çfarë baze ligjore funksionon, kur nuk kemi ligje bazike të punës dhe ligj të sigurimit pensional dhe invalidor. Nuk mund të kemi as investitorë, kur nuk kemi ligj të punës. Kjo dikujt i pëlqen.

Rita Hajzeraj – Nuk kemi përgjigje nga ministri, pse është shtyrë miratimi i Projektligjit të punës. Mendoj se miratimi i tij e rrit buxhetin, por nuk e dëmton. Të punësuarit në sektorin privat askund nuk janë të evidencuar, sepse nuk kemi ligj të punës. Duhet të gjendet një zgjidhje që edhe nëse nuk e kemi një ligj të mirë, së paku ta kemi një ligj. Propozoj t'i ftojme përfaqësuesit e BB-së dhe të FMN-së, ministrin dhe zëvendëskryeministrin që të bisedojmë si ta gjejmë një zgjidhje. Për shkaqe teknike nuk është e drejtë të mos miratohet Ligji i punës. Ky Ligj nuk po u pëlqen bizneseve private, sepse po i shfrytëzojnë punëtorët në mënyra të ndryshme. Edhe FMN-së duhet t'i ofrojmë plan konkret për zgjidhje.

Flora Brovina – Tha se Komisioni është duke e mbikëqyrur zbatimin e Ligjit të Inspektoratit të punës. Kemi vërejtur se pengesat në zbatimin e këtij Ligji janë pikërisht mungesa e Ligjit të punës. Ne nuk mund të pranojmë ligje të tjera pa miratimin e Ligjit të punës. Për problemin e pensioneve të punëtorëve tanë, që kanë punuar në Zvicër, pyetja ime është: A keni marrëveshje me shtetet e tjera ku kanë punuar punëtorët tanë, si Gjermania, Kroacia etj, në mënyrë që të mos paraqitet i njëjti problem?

Gjylnaze Sylja – Sipas njoftimeve, që morëm nga ministri, këtë vit nuk do të kemi as ligj të punës, as ligj të sigurimit pensional e as ligj të asistencës sociale. Nëse nuk është kështu, pres përgjigje konkrete nga ministri, kur do t'i kemi këto ligje? Ju thatë se pritet një marrëveshje ndërmjet kryeministrit dhe pensionistëve, një rritje e pensioneve e paraparë me ligj nga rebalancët. A mund të na jepni shpjegime për këtë rritje? A është duke u rritur numri i personave, që po kërkojnë asistencë sociale, sepse popullata jonë çdo ditë e më tepër po varfërohet? Zbatimi i *Letrës së Bardhë*, nuk mund të bëhet pa rritje të buxhetit, kurse rritje të buxhetit nuk ka pa zhvillim ekonomik. A ka Qeveria plane dhe projekte për rritje ekonomike?

Nurishahe Hulaj – Ju pyes për projektet edukative në komuna, që janë trevjeçare. Çfarë do të ndodhë pas tre vjetësh me këta të punësuar? Ky është punësim jo i qëndrueshëm. Duhet të kemi punësim të qëndrueshëm.

Nenad Rashiq – Vende të reja të punës ka, por rritje të punësimit nuk ka. Kosova do të ketë zhvillim ekonomik, por nevojitet kohë.

Ligji i punës shumë shpejt do të vijë në Kuvend. Për kohën e saktë nuk mund t'ju them, sepse kjo varet edhe nga disa procese në Qeveri. Procesi është i lidhur edhe me FMN-në dhe me BB-në. Edhe ne jemi pjesë e krizës ekonomike botërore dhe kjo ka pasur reflektime. Sa i përket asistencës sociale kemi probleme me komunat, sepse asistencë sociale është e decentralizuar dhe në komuna çdo ditë po rritet numri i personave në listën e asistencës sociale.

Qamile Morina – Nuk morëm fare përgjigje nga ministri për afatin se kur do të vijë në Kuvend Ligji i punës dhe Ligji i pensioneve, prandaj e përkrah propozimin ta ftojme ministrin e MPMS-së, bashkë me BB-në dhe FMN-në, që të diskutojmë më hollësisht.

Sa u përket sigurimeve sociale kërkoj nga Ministria ta krijojë një databazë dhe t'i mbikëqyrë ndihmat sociale.

Nenad Rashiq – Sa i përket asistencës sociale, i kemi mbikëqyrur 3 komuna. Në to ka shkelje të mëdha. Do ta kemi edhe një takim me kryetarët e komunave dhe do të kërkojmë që situata të përmirësohet. Nëse nuk përmirësohet do të merren masa të rrepta.

Sadik Idriz – E falënderoj ministrin për paraqitjen para Komisionit.

3. Të ndryshme

Sadik Idriz – Në mbledhjen e radhës do t'i shqyrtojmë amendamentet e Ligjit për Kryqin e Kuq dhe Ligjin për Emblemën e Kryqit të Kuq. Do të diskutojmë edhe për procedurën e mëtejme të Ligjit për produkte dhe për pajisje medicinale. Do ta shqyrtojmë edhe mundësinë e një vizite në Slloveni.

Mbledhja përfundoi në orën 14: 40

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Sadik Idriz